



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të grupit të operatorëve ekonomik "Sahit Mecini" B.I. & "N.N. 100% Design" Sh.P.K. të datës 31.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 28.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi dhe rregullimi i tërësishëm i sistemit të klimatizimit në objektin e ri të Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-7990-1-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim të grupit të operatorëve ekonomik "Sahit Mecini" B.I. & "N.N. 100% Design" Sh.P.K. të datës 31.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 28.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi dhe rregullimi i tërësishëm i sistemit të klimatizimit në objektin e ri të Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-7990-1-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Sahit Mecini" B.I. & "N.N. 100% Design" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Sahit Mecini" B.I. & "N.N. 100% Design" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 31.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 28.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi dhe rregullimi i tërësishëm i sistemit të klimatizimit në objektin e ri të Komunës" me nr. prokurimi 616-23-7990-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar se grupi i operatorëve ekonomik "Harst Group" Sh.P.K. & "Ekotermika" Sh.P.K. si tenderues i rekomanduar për kontratë "nuk i ka këto ISO standarde valide për vitin 2023 dhe nuk janë të noterizuara sipas ligjit 06/L-010 neni 47 par. 3.1".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit fillimisht duhet cekur se për parashtruesin nuk është fare kontestuese se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar certifikatat ISO së bashku me vërtetimet noteriale sikurse janë kërkuar me dosjen e tenderit. Për parashtruesin është vetëm kontestues fakti nëse këto dokumente janë valide për vitin 2023 dhe nëse vërtetimet noteriale të këtyre dokumente janë lëshuar në përputhje me ligjin përkatës për noterinë". Në këtë drejtim duhet theksuar se në këtë rast është bërë ekzaminimi, krahasimi dhe vlerësimi i të gjitha ofertave tenderuesve nga një komision profesional dhe objektiv. Nga raporti i vlerësimit rezulton se tenderuesi i rekomanduar ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe rrjedhimisht është konfirmuar si tenderuesi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë. Njëkohësisht nga dosja e tenderit është konfirmuar se të gjeturat e komisionit vlerësues në këtë rast janë të sakta dhe tërësisht të qëndrueshme. Në anën tjetër parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet parashtruesit janë të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 01.09.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 2 nga 2

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net